



VIRTYTI

*Kush do të gjejë një grua . . . të virtytshme?
Vlera e saj është shumë më e madhe nga ajo
e margaritarëve (Fjalët e Urta 31:10).*



Unë do të përgatitem të hyj në tempull
dhe të mbetem e pastër dhe e denjë.
Mendimet dhe veprimet e mia do të
bazohen mbi standarde të larta morale.



PËRVOJAT E VLERËS SË VIRTYTIT

Plotësoni katër Përvojat e mëposhtme të nevojshme të Vlerës.

I kërkoni njërit prej prindërve apo një udhëheqëseje të firmosë dhe të shkruajë datën e përfundimit të secilës përvojë, pasi ta përfundojnë.

1. Virtyti është një model mendimi dhe sjellje bazuar në standarde të larta morale. Ai përfshin dëlirësinë dhe pastërtinë morale. Fuqia për të krijuar jetë të vdekshme është një fuqi ekzaltuese që Perëndia u ka dhënë fëmijëve të Tij. Ai ka urdhëruar që kjo fuqi të përdoret vetëm midis një burri dhe gruaje, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte. Studioni kuptimin dhe rëndësinë e dëlirësisë dhe virtytit duke lexuar Moroni 9:9, Jakobi 2:28, “Familja: Një Proklamim Drejtuar Botës,” dhe “Pastërtia Seksuale” në *Për Forcën e Rinisë*. Lexoni gjithashtu Nenin e Besimit numër trembëdhjetë dhe Fjalët e Urta 31:10–31. Në ditarin tuaj shkruani bekimet e premtuara nga të qenit i pastër seksualisht dhe zotimin tuaj për të qenë e dëlirë.
2. Jeta e virtytshme “në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet” ju kualifikon për shoqërinë e vazhdueshme të Frymës së Shenjtë. Kur pagëzoheni dhe konfirmoheni, ju jepet dhurata e Frymës së Shenjtë për t’ju udhëhequr në të gjitha aspektet e jetës tuaj. Meqenëse Fryma e Shenjtë nuk banon në tabernakuj të papastër, të jetuarit e një jete të virtytshme është një parakusht për të pasur shoqërinë e Frymës së Shenjtë dhe për të marrë bekimet e ordinancave të tempullit. Lexoni referencat e mëposhtme të shkrimeve të shenjta dhe identifikoni bekimet e premtuara: Gjoni 14:26–27; Gjoni 15:26;





2 Nefi 32:1–5; DeB 45:57–59; DeB 88:3–4; dhe DeB 121:45–46. Në ditarin tuaj mbani shënim atë që keni mësuar dhe shkruani rreth një periudhe kur ndiet udhëheqjen e Frymës së Shenjtë.

- 3. Përgatituni për të qenë e denjë për të hyrë në tempull dhe për të marrë pjesë në ordinancat e tempullit. Lexoni Alma kapitulli 5. Bëni një listë të pyetjeve që bën Alma. Përgjigjuni pyetjeve për veten tuaj dhe bëni një listë të gjërave që mund dhe do të bëni për t'u vetëpërgatitur që të jeni e pastër dhe e denjë për të hyrë në tempull dhe për të marrë bekimet që Ati ynë Qiellor i ka premtuar bijave të Tija të dashura.
- 4. Meqenëse Shpëtimtari ju do dhe ka dhënë për ju jetën e Tij, ju mund të pendoheni. Pendimi është një akt i besimit në Jezu Krisht. Lexoni Moroni 10:32, librin e Enosit dhe seksionin e pendimit tek *Për Forcën e Rinisë*. Sakrifica shlyese e Shpëtimtarit ka bërë të mundur që t'ju falen mëkatet tuaja. Lexoni lutjet e sakramentit në DeB 20:77–79. Vendosni të merrni denjësisht prej sakramentit çdo javë dhe ta mbushni jetën tuaj me aktivitete të virtytshme që do t'ju sjellin forcë shpirtërore. Ndërsa e bëni këtë, ju do të rriteni në aftësinë për t'i bërë ballë tundimit, për të mbajtur urdhërimet dhe për t'u bërë më shumë si Jezu Krishti. Vendosni se çfarë mund të bëni çdo ditë për të mbetur të pastra e të denja dhe shkruani planin tuaj në ditar.



PROJEKTI I VLERËS SË VIRTYTIT

Pasi të keni përfunduar katër Përvojat e nevojshme të Vlerës së Virtytit, plotësoni projektin e mëposhtëm për vlerën e Virtytit:

Shpëtimtari zgjodhi të bënte një jetë të virtytshme. Ndiqni këshillën e Tij “mëso nga unë” (DeB 19:23) duke lexuar të gjithë Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit. Krahasoni shkrimet e shenjta me jetën e rrethanat tuaja. Ndërsa lexoni, shënoni mendimet tuaja rregullisht në ditarin tuaj. Vini re shembullin e jetës dhe misionit të Shpëtimtarit. Çfarë bëri Shpëtimtari dhe ata që e ndoqën Atë, për të jetuar në mënyrë të virtytshme? Kur të keni përfunduar leximin tuaj, shënoni dëshminë tuaj në ditar.




“Unë u thashë vëllezërve se Libri i Mormonit ishte më i sakti nga ndonjë libër mbi tokë dhe gurthemeli i besimit tonë, dhe se një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër” (Jozef Smith, në Parathënien e Librit të Mormonit).





“Më tregoni një të re që e do shtëpinë dhe familjen, që i lexon dhe mediton mbi shkrimet e shenjta çdo ditë, që ka një dëshmi të zjarrtë të Librit të Mormonit. Më tregoni një të re që merr pjesë besnikërisht në mbledhjet e saj të kishës, që është diplomuar në seminar, që ka marrë Çmimin e saj të Njohjes së të Resë dhe e vë atë me krenari! Më jepni një të re që është e virtytshme dhe që ka ruajtur pastërtinë e saj personale, që nuk do të synojë për diçka më poshtë se martesë në tempull dhe unë do t’ju tregoj një të re që do të bëjë mrekulli për Zotin tani dhe përgjatë përjetësisë” (Ezra Taft Benson, “To the Young Women of the Church,” Ensign, nëntor 1986, f. 84).



Virtyti



KISHTA E
JEZU KRISHTIT
I SHENJTOREVE TE
DIEVE TE MIVONSEME

© 2009 nga Intellectual Reserve, Inc.
I rezervohen të gjitha të drejtat.
Shtypur në Gjermani.
Miratimi në anglisht: 12/08.
Përkthim i *Virtue*. Albanian. 08255 101

ALBANIAN

